



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AAB CONSTRUCTION" të datës 08.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i i parkut në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-25-1776-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB CONSTRUCTION" të datës 08.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AAB CONSTRUCTION" (tutje "parashtruesi") me datë 08.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut në Hajvali" me nr. të prokurimit 616-25-1776-5-2-1

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. b) është përcaktuar se "Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)". Në rastin konkret njoftimi mbi vendimin është publikuar njoftimi mbi vendimin është publikuar me datë 01.08.2025 pas orës 16:00 që llogaritet sikurse të jetë publikuar me datë 02.08.2025. Kjo nënkupton që data 02.08.2025 të jetë dita zero (0) ndërsa data e fundit kur kanë mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin ka qenë data 07.08.2025 deri në ora 16:00.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e dt. 08.08.2025 është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.